



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

E.nr.710/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbarimore të kreditorëve : F.S., A.F., B.B., R.M. dhe B.H., të cilët i përfaqëson av Urim Bajraktari nga Ferizaj, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria e Arsimit, për pagesën ushqimit dhe udhëtimit dhe shpenzimet të procedurës, më datë 13.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbarimore në lëndën **E.nr.710/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorëve.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.710/23, të datës 15.05.2023, e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e të ardhurave personale si dhe shpenzimeve të procedurës kontestimore dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2022:112734, të datës 12.10.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 21.09.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 2,238.00 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorëve.

Meqenëse kreditorët e kanë realizuar kërkesën e tyre, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.710/23, më datë 13.06.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi